



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Durrës 19.01.2026

Lënda : Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

Në lidhje me pyetjet nr. 1 dhe nr. 3 ju bëjmë me dije se: Informacioni i shpërndarë nga Bashkia e Durrësit me datë 08.01.2026, është marrë nga Ndërmarrja Komunale Plazh.

Dëshirojmë të sqarojmë se ky informacion ka qenë paraprak dhe është dhënë në përgjigje ndaj interesimit të mediave. Sqarimi i plotë i kësaj ngjarjeje fatkeqë po kryhet nga organet kompetente.

Në lidhje me pyetjen nr. 2 ju bëjmë me dije se:

Z. Astrit Hysenaj ishte i punësuar pranë Ndërmarrjes Komunale Plazh me detyrë punëtor për evadimin e mbeturinave prej 22 vitesh.

Detyra që kryente z. Astrit Hysenaj në përputhje me orarin dhe detyrat funksionale të përcaktuara nga Ndërmarrja Komunale Plazh ishte: Punonjës evadimi mbeturinash, kryente fshirjen me fshesë të gjithë rrugës sipas grafikut të caktuar {Rruga Qafë Botë}. Kryente fshirjen e rrugicave brenda blloqeve të banimit. Bënte grumbullimin e mbeturinave në pika të caktuara për tu evaduar nga kamionët e hapur.

Më datë 06.01.2026, në orën 06:00, ai është paraqitur në vendin e punës si çdo ditë dhe ka filluar punën për pastrimin e zonës. Zona ku z. Hysenaj kryente aktivitetin e tij të përditshëm të punës ishte Rruga “Qafë Botë”, sektori Iliria, lagjja nr. 13, Plazh. Zona në të cilën kryente punën e tij kufizohej nga shinat e trenit, Hotel Miki, Rruga Pavarësia dhe fundi i rrugës Qafë botë përballë Hotel Floridës.

Bashkëlidhur këtij e-maili po ju dërgojmë hartën orientuese të zonës ku z. Astrit Hysenaj ushtronte aktivitetin e tij të përditshëm të punës.

Kjo zonë ndodhet jashtë perimetrit ku, sipas informacionit të shpërndarë nga Drejtoria Vendore e Policisë dhe mediave, është gjetur trupi i pajetë i z. Astrit Hysenaj.